

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ilir Rashkaj, me procesmbajtësin Shani Canziba, sekretar juridik i kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit G. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.1207/2016 të datës 26.10.2016, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 01.08.2018, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Bajram Kryeziu, dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

G. K., nga i ati S. dhe e ëma N., e gjinisë B., i lindur me datën ..., në fshatin Z., Komuna e Rahovecit, tani me banim në Prizren, Rr. "F. H." p.nr, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e filllore, i pa martuar, punëtor fizik, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me dt.09.08.2016 rreth orës 12:30 min, në Rahovec, rr. "Xh. e A. E.", i revoltuar me të dëmtuarin, vjehërr motre, për rrahje ditë më parë të motrës në një aheng familjarë, e ti hakmerret shkon me automjet, me trg.regj....-...-..., afër pompës "A. P." e kur e vëren të dëmtuarin duke ecur në këmbë, e ndez automjetin e me të e sulmon dhe e godet në këmbë ku e përplas në tokë, e me automjet largohet me të shpejtë nga vendi i ngjarjes e nga kjo të dëmtuarit, R. (H.) B. nga Rahoveci, rr. "Xh. e A. E." pn, i shkakton lëndime të lehta trupore të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore me nr.ref.GK-202 të Dr. N. U. dt.24.10.2016.

- Me çka ka kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform neneve 4, 6, 7, 17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52 dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, të njëjtit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që, të akuzuarin G. K., e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditësh, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari, që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej 20.44 Euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

I dëmtuari R. H. B. nga Rahoveci, Rr. "Xh. e A. E.", p.nr., udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Gjakovë, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP.nr.1207/2016 të datës 26.10.2016, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin G. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe ka propozuar që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të provave i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata, me datë 01.08.2018, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, dhe kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Bajram Kryeziu dhe i akuzuari G. K., me ç'rast prokurori i shtetit edhe pas leximit dhe analizimit të aktakuzës ka qëndruar në tërësi pranë saj, si dhe ka bërë plotësimin e kualifikimit të veprës penale, ashtu që pas "paragrafit 2", duhet të jetë dhe lidhur me par. 1 të KPRK-së", ndërsa në pjesën tjetër mbetet e pandryshuar.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të pranojë ose të mos e pranojë fajësinë, por paraprakisht i'a ka tërhequr vërejtjen lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që i ngarkohet.

I akuzuari G. K., ka deklaruar se: E pranon fajësinë, e ndien vetën fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe ndjen keqardhje. Po ashtu ka shtuar se këtë e ka bërë në moment dhe tani ndjen keqardhje, ndërsa të dëmtuarin e ka mik, dhe nga ajo kohë e deri më sot nuk kanë pasur probleme. Andaj, duke pasur parasysh se veq e kanë tejkaluar këtë mosmarrëveshje e ka lutur gjykatën që kjo çështje të kryhet sa më parë. Gjithashtu, ka premtuar para gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej veprë tjetër penale, si dhe e ka lutur gjykatën që me rastin e caktimit të dënimit të ketë parasysh faktin se është i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, andaj duke pas parasysh të lartcekurat e ka lutur gjykatën që me rastin e caktimit të dënimit t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjykata, gjithashtu e ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit, sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit Bajram Kryeziu, ka deklaruar se: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pasi që i njëjti e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë me vetëdije dhe vullnet të plotë, si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës. Gjykatës i ka propozuar që me rastin e caktimit të dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese, si pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte në gjykim, kërkim faljen, si dhe rrethanat rënduese nëse gjenë, dhe të njëjtit t'ia shqiptojë një dënim në proporcion me peshën e veprës penale.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, e meqenëse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe nuk është lëshuar në procedurën e provave e as në fjalën përfundimtare por e ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktakuzës.

Gjykata, ka gjetur se i akuzuari ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe gjendjen e këtyre faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte e përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë: Deklarata e të akuzuarit e dhënë në Stacionin Policor në Rahovec dt.13.08.2016; Deklarata e të dëmtuarit dhënë në Stacionin Policor në Rahovec dt.11/12.08.2016; Deklarata e dëshmitares e dhënë në polici dt.13.08.2016; Raporti mjekësor nr.11123 e dt.09.08.2016 lëshuar nga Spitali Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë; Raporti mjekësor i QKMF Rahovec dt.09.08.2016; Raporti i Oficerit i dt.13.08.2016; Ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. N. U. e dt.24.10.2016, si dhe foto-dokumentacioni dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Prandaj, në bazë të këtyre provave dhe vet pranimi të fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 73 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të të akuzuarit, pranimin e fajësisë, pendimin për rastin që ka ndodhur, se është hera e parë që kanë rënë në kundërshtim me ligjin, i njëjti në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, të dëmtuarin e ka mik dhe janë pajtuar, premtimin para gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, është i pa punë, si dhe gjendjen e dobët ekonomike, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, gjykata ka ardhur në përfundim se me shqiptimin e dënimit me kusht, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 41 par. 1 dhe 2 të KPK-së, dhe ky dënim është në proporcion me peshën e veprës, me sjelljen dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, u mor konform nenit 450 paragrafi 1 dhe 2 nën par. 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC

- Divizioni Penal -

P.nr.395/2016 me datë 01.08.2018

Sekr. Juridik,
Shani Canziba

Gjyqtari i vetëm gjykses,
Ilir Rashkaj

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.